RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

KOMUNIKATË

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, mbajti mbledhjen e radhës sipas agjendës së përcaktuar në rend dite.

Sot, me datë 08 korrik 2026, në mbledhjen e Bordit të RTK-së, të mbajtur në kuadër të procedurës së konkursit publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët, përfshirë edhe dokumentacionin plotësues të paraqitur brenda afatit të përcaktuar.

Pas përfundimit të shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, Bordi konstatoi se në konkurs kanë aplikuar 8 kandidatë, prej të cilëve 6 kandidatë kanë përmbushur kushtet e përcaktuara në konkurs dhe kualifikohen për fazën e intervistimit. Kandidatët që kanë plotësuar kushtet janë: Lorik Arifaj, Antigonë Baxhaku, Hysen Hundozi, Arber Geci, Nexhmedin Spahiu dhe Zana Spahiu.

Ndërkaq, 2 kandidatë të tjerë nuk kanë dëshmuar, përmes dokumentacionit të dorëzuar, përmbushjen e kushteve të konkursit dhe, rrjedhimisht, nuk kualifikohen për fazën e mëtejme të procedurës.

Procedura e përzgjedhjes do të vazhdojë me fazën e intervistimit, në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme në fuqi.

Bordi i RTK-së mbetet i përkushtuar për një proces të rregullt, transparent dhe të paanshëm, në përputhje me parimet e meritës, mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta, duke qenë i hapur për monitorimin e këtij procesi gjatë gjithë procedurës dhe nga të gjithë të interesuarit.